



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 18/5 Prot.

Tiranë, më 08/12/2011

Lënda: Rekomandim për Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k.

REKOMANDIM

Nr. 18/5, datë 08/12/2011

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k,

KONSTATOVA

Më datë 21/11/2011, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

Verifikimi i zbatimit të Rekomandimit Nr.18/3 prot., datë 17.11.2010, të vendosur nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në ngarkim të kontrolluesit Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k.

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara, vëren se:

Me Rekomandimin Nr.18/3, datë 17.11.1010, ju është kërkuar të hartoni një rregullore të veçantë, ose të përfshinit në Rregulloren tuaj të Brendshme, dispozita ose rregulla që sigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale, mbledhjen dhe përpunimin e tyre, duke parashikuar edhe kohëzgjatjen e ruajtjes dhe mbajtjes së këtyre të dhënave, si më poshtë:

Të hartohet rregullore e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin ose në rregulloren ekzistuese të përfshihet një rubrikë në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale ku të parashikohet edhe kohëzgjatja e mbajtjes së të dhënave personale, sipas qëllimit për të cilin ato janë grumbulluar, duke zbatuar kërkesat e neneve 5, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

